



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 08 Janar 2024

Lënda: Kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 106/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8991, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit””.

Drejtuar: **SH.T.Z. Bajram BEGAJ**
President i Republikës së Shqipërisë

Për dijeni: **Ambasadorëve të Trupit Diplomatik të Akredituar në Tiranë**

I nderuar z. President i Republikës,

Gjatë dy viteve të para të kësaj legjislature (2021 – 2023), mazhoranca socialiste ka refuzuar ngritjen e 8 (tetë) komisioneve hetimore të kërkuara nga deputetët e grupeve parlamentare të opozitës. Vetëm gjatë sesionit të fundit parlamentar (tetor – dhjetor 2023), mazhoranca ka refuzuar ngritjen e tre komisioneve hetimore njëherazi, përkatësisht me objekt hetimi kontratat koncesionare në sektorin e shëndetësisë, ndërhyrjet e paautorizuara në sistemin TIMS dhe rastet e konfliktit të interesit në vendimmarrjet publike.

Këto vendimmarrje refuzuese kanë qenë në kundërshtim flagrant me nenin 77, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 25, pika 1, të Rregullores së Kuvendit. Këto dy dispozita sanksionojnë nga njëra anë, të drejtën e një të katërtës së anëtarëve të Kuvendit (35 deputetë) për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor dhe nga ana tjetër, detyrimin e Kuvendit për të pranuar këtë kërkesë. Ky detyrim i Kuvendit për të pranuar ngritjen e një komisioni hetimor është konfirmuar në mënyrë të përsëritur nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Në vendimin nr. 18, datë 14.05.2003, Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

Nga ana tjetër, dispozita kushtetuese, duke parashikuar shprehjen “është i detyruar” merr një tjetër kuptim dhe nuk interpretohet në të njëjtën mënyrë me rastin e mësipërm. Përdorimi në Kushtetutë i shprehjes “është i detyruar”, jo vetëm që e vendos Kuvendin në një pozicion disi të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për ngritjen e një komisioni hetimor, por njëkohësisht institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushteti i pakicës parlamentare.

E drejta e hetimit parlamentar është zhvilluar në kuptim e së drejtës së pakicave në parlamentar, pavarësisht nga pozicionimi i tyre politik me qëllim, që t’u japë atyre një pushtet më të fortë. Së bashku me mjetet e tjera si pyetjet, interpelancat, apo mocionet për debat, ngritja e komisioneve të hetimit përbën një instrument të rëndësishëm kontrolli që ushtrohet nga parlamenti. E drejta e hetimit realizohet vetëm, brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që parlamentarët kryejnë si përfaqësues të popullit për sqarim, apo hulumtim të hollësishëm në çështjen konkrete.

Kjo e drejtë shërben njëkohësisht edhe si një mjetet në duart e pakicës parlamentare për të ushtruar kontroll kryesisht kundrejt ekzekutivit dhe për të kërkuar vënien përpara përgjegjësisë të mbajtësve të pushtetit. Në një sistem parlamentar, duke qenë se qeveria formohet nga shumica parlamentare, e cila ka në dorë shumë mjete të tjera ligjore, e drejta e kontrollit hetimor i është njohur sidomos pakicës, që duke i patur të kufizuara mjetet e saj, ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues.

Kushtetuta, në nenin 77, pika 2 duke njohur të drejtën për të ngritur komisione hetimore, si e drejtë e një së katërtës së deputetëve për të vepruar në mënyrë të pavarur nga shumica parlamentare, ka evituar njëkohësisht edhe disa pengesa ligjore që mund të krijohen si rrjedhojë e vendimmarrjes. Nëpërmjet shprehjes “është i detyruar” ajo ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit, duke vendosur një balancë ndërmjet shumicës për të vendosur dhe të drejtës së pakicës së cilësuar.

Nga ky këndvështrim i problemit, Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta e pakicës vetëm përsa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor mbetet një e drejtë e pakufizuar nga vullneti i shumicës. Njëkohësisht, e drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për të ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e pakicës, me përjashtim të rasteve, kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohen se preken parimet kushtetuese.

Në të njëjtën linjë mendimi, në vendimin nr. 20, datë 04.05.2007, Gjykata Kushtetuese shprehet se:

Gjykata Kushtetuese e cilëson si “kompetencë kushtetuese” të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Duke e veshur një të katërtën e deputetëve me këtë pushtet, Kushtetuta “...institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare”, që realizohet “...në mënyrë të pavarur...” dhe që është “...i pakufizuar nga vullneti i shumicës”. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila, duke i pasur të kufizuara mjetet, “mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues”.

Kushtetuta “...ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit” dhe, mbi këtë bazë, Kuvendi “...ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit” kur kjo kërkohet nga pakica parlamentare. Objekti i hetimit “...nuk mund të reduktohet nga Kuvendi deri në atë masë sa t’ia bëjë të pamundur komisionit kryerjen e veprimtarisë”. Prandaj, jurisprudenca e ka pranuar tashmë se “...e drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për të ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e pakicës, me përjashtim të rasteve, kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohen se preken parimet kushtetuese.”

Më tej, në vendimin nr. 30, datë 16.05.2014, Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

*34. Gjykata konstaton se gjatë debatit të lartpërmendur, diskutimet në Konferencën e Kryetarëve dhe në seancën plenare në Kuvend nuk janë zhvilluar në drejtim të arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet palëve lidhur me objektin e hetimit, deri në marrjen e një vendimi. **Shumica parlamentare në rastet kur pretendon se çënohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e hetimit, është e detyruar të propozojë formulime alternative duke i dhënë mundësinë pakicës të riformulojë kërkesën e saj.** Në rastin në shqyrtim, debate nuk ka pasur si orientim kryesor mbrojtjen e të drejtës kushtetuese të*

pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, por mohimin e saj. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se vendimi i Kuvendit, në këtë aspekt, nuk është i pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

51. Për këto arsye, Gjykata çmon se përderisa pushteti i pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të vihet në dyshim, fakti se një çështje e ngjashme po hetohet nga prokuroria nuk krijon pengesë a priori në ngritjen e tij. Është detyrë e komisionit hetimor dhe e Kuvendit, që pas ngritjes së Komisionit, të përqendrohen në objektin e hetimit parlamentar, në mënyrë të tillë që të shmanget çdo ndërhyrje në veprimtarinë e organit të prokurorisë, në rastin konkret, apo të organeve të tjera shtetërore, nëpërmjet dublimit apo zëvendësimit të kompetencave, gjë që mund të krijonte një situatë konflikti kompetencash midis tyre. Këtë qëndrim ka mbajtur kjo Gjykata edhe në vendimin nr. 20, datë 04.05.2007.

Nga përmbajtja e tre vendimeve të sipërcituara të Gjykatës Kushtetuese mund të arrihet në konkluzionin se Kuvendi është i detyruar të ngrëjë një komision hetimor kur kërkohet nga një e katërta e anëtarëve të tij, pa ia nënshtruar debatit parlamentar apo procedurave të zakonshme të votimit, me përjashtim të rasteve kur shumica parlamentare ngrë pretendime sa i përket cënimit të parimeve kushtetuese. Në këto raste përjashtimore, shumica nuk ka të drejtë të vendosë rrëzimin e kërkesës apo refuzimin e ngritjes së komisionit hetimor, por propozon formulime alternative me qëllim që të arrihet dakordësia për objektin e veprimtarisë. Megjithatë, këto riformulime nuk mund të jenë të atilla sa të zhbëjnë thelbin e objektit apo të pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së komisionit. Duke u ndalur te parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, Gjykata është shprehur se ekzistenca e një çështjeje të ngjashme në hetim nga prokuroria nuk përbën pengesë a priori për ngritjen e një komisioni hetimor. Qëndrim ky, i konfirmuar edhe nga drejtuesi i SPAK, z. Altin Dumani në një reagim publik për INA Media, të datës 6 nëntor 2023.¹

Pikërisht, nisur nga refuzimi i përsëritur i shumicës parlamentare për të ngritur komisionet hetimore të kërkuara nga deputetët e opozitës, duke filluar nga data 5 tetor 2023 e në vijim, Parlamenti është përfshirë nga një situatë jonormale gjatë punimeve parlamentare, sa kohë deputetët e opozitës kërkojnë garantimin e të drejtave kushtetuese të opozitës parlamentare, ndër të cilat dhe më e rëndësishmja, e drejta e ngritjes së komisioneve hetimore të Kuvendit.

Qëndrimi i mbajtur nga deputetët e opozitës u reflektua edhe në progres raportin e Komisionit Evropian për vitin 2023, në të cilin thuhet se: “Gjatë periudhës raportuese, opozita kërkoi ngritjen e dy komisioneve hetimore, por mazhoranca i hodhi poshtë të dyja kërkesat, pavarësisht se e drejta e opozitës për të nisur komisione të tilla garantohet me Kushtetutë.”. Në të njëjtën linjë ishin edhe reagimet e trupit diplomatik në Shqipëri, përkatësisht ambasadave të SHBA-së, BE-së, Britanisë së Madhe, Gjermanisë dhe Italisë, të cilat kërkonin funksionimin normal të Parlamentit, ku përfshihet edhe garantimi i funksionit të tij kontrollues ndaj ekzekutivit.

Megjithë situatën e tensionuar në Kuvend, reagimet dhe thirrjet e partnerëve ndërkombëtare për dialog konstruktiv ndërmjet palëve me qëllim garantimin e të drejtës së kontrollit parlamentar efektiv, mazhoranca socialiste dukej e vendosur për t'i shkuar deri në fund qëndrimit të saj antikushtetues, për bllokimin e ngritjes së Komisioneve Hetimore, duke materializuar qëndrimin e saj nëpërmjet një projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, 02.05.2003 “Për

¹https://ina.media/?p=7509&fbclid=IëAR2EefëiëbjghO3P6Yq3_Kt3YEaNJOYgtyUtq3n4q91HIOI94fTTEp2TtLo_aem_AXyOtB99MzN6inMoQDE9T5i-yf77F-RyQr6Jiguy0jcZO1QvBVsyO-RQ5YD3iflSpU0

organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, të depozituar në datën 30.11.2023, në kulmin e debateve mes palëve në Kuvend. Ky projektligj, siç do të analizojmë në vijim ka në vetvete tre qëllime kryesore: (i) ligjërimin e vendimmarrjeve antikushtetuese të deritanishme për rrëzimin e kërkesave të deputetëve të opozitës për ngritjen e komisioneve hetimore; (ii) vendosjen nën kontroll të plotë të mazhorancës të drejtën e deputetëve të opozitës për ngritjen e komisioneve hetimore; dhe (iii) në rast të ngritjes së komisioneve hetimore, pamundësimin e ushtrimit të kontrolli hetimor parlamentar efektiv.

Por, përpara se të ndalemi në këtë analizë vlerësojmë të rëndësishme të sjellim në vëmendjen tuaj se pas përfundimit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor Parlamentar për Inceneratorët, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka dorëzuar një projektligj në datën 09.12.2022, i cili synonte adresimin e disa problematikave që kishin lindur gjatë veprimtarisë së këtij komisioni. Përgjatë një viti, ky projektligj nuk u përfshi në procedurat parlamentare të shqyrtimi, përkatësisht në komisione parlamentare dhe seancë plenare.

Nga ana tjetër, megjithëse mazhoranca dhe opozita kishin dakordësuar në parim në Konferencën e Kryetarëve për ngritjen e një komisioni të posaçëm parlamentar, i cili do të kishte për objekt të veprimtarisë së tij dakordësimin e ndryshimeve ligjore në ligjin për komisionet hetimore të Kuvendit. Madje, deputetët e opozitës kishin propozuar edhe dy përfaqësuesit e tyre për anëtarë të këtij komisioni. Vendimi për ngritjen e këtij komisioni nuk u materializua asnjëherë nga mazhoranca socialiste si dëshmi e qartë e vullnetit të tyre për të vazhduar miratimin e shtesave dhe ndryshimeve ligjore në mënyrë të njëanshme.

Megjithëse nuk ishte pjesë e Kalendarit të Punimeve të Kuvendit për periudhën 27 nëntor – 22 dhjetor 2023, të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve më datë 19.11.2023, Komisioni për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me praninë vetëm të deputetëve të mazhorancës, në një mbledhje në platformën online Zoom, ka vendosur miratimin e projektligjit dhe kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare. Kjo mbledhje është zhvilluar në kundërshtim me nenin a/5 të Rregullores së Kuvendit që përcakton se zhvillimi i mbledhjeve online mund të bëhet vetëm në rastet e masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Pa ia nënshtruar asnjë debat apo diskutim ndërmjet palëve, mazhoranca socialiste në seancën plenare të datës 21 dhjetor 2023, ka miratuar ligjin nr. 106/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”.

Nga sa më sipër, mund të kuptohet qartësisht se mazhoranca socialiste nuk ka kryer asnjë përpjekje për dialog, mirëkuptim apo konsensus për adresimin e ndryshimeve ligjore që prekin një të drejtë thelbësore të opozitës parlamentare, të garantuar nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit, dhe të konfirmuar në mënyrë të përsëritur nga Gjykata Kushtetuese. Procedura e ndjekur në vetvete nga mazhoranca, vlerësojmë se përbën shkak të mjaftueshëm për Presidentin e Republikës për të vendosur kthimin për rishqyrtimit të këtij ligji. Megjithatë, në vijim do të ndalemi në analizën e përmbajtjes së këtij ligji dhe problematikave të tij.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara nëpërmjet këtij projektligji mund t’i kategorizojmë në dy grupe. Në grupin e parë përfshihen ndryshimet që kanë për qëllim të rregullojnë kuptimin e komisioneve hetimore të Kuvendit dhe kushtet për ngritjen e tyre, ndërsa në grupin e dytë përfshihen ndryshime që lidhen me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të komisioneve hetimore. Që nga ky kategorizim mund të kuptohet se grupi i parë i ndryshimeve është jashtë

objektit të këtij këtij ligji pasi kuptimi i komisioneve hetimore, ashtu si edhe kushtet për ngritjen e tyre janë të mirëpërcaktuara në Kushtetutë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa ligji ka për objekt vetëm mënyrën e organizimit dhe funksionimit të komisioneve hetimore. Konkretisht, duke u ndalur në grupin e parë të ndryshimeve vërejmë se në nenin 1 është shtuar përkufizimi i “çështje e veçantë”, si çështje që hetohen në aspektin e kontrollit dhe zbatimit të ligjeve, të njohjes dhe verifikimit në thellësi të një fenomeni, ngjarje a veprimtarie dhe që nxisin iniciativa për propozime, amendime dhe miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë dhe shtetin, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive institucionale. Në nenin 2, është shtuar një fjali sa i përket fushës së veprimtarisë së komisioneve hetimore, duke përcaktuar se ato janë një mjet efektiv kontrolli vetëm brenda hapësirë kontrolluese të parlamentit e të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit.

Më tej, në nenin 3 janë parashikuar parimet mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë komisionet hetimore të Kuvendit, përkatësisht parimet e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, procesit të rregullt ligjor, prezumimit të pafajësisë, paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit. Në nenin 4 është shtuar edhe një listë tjetër të ashtuquajtura parimesh, të cilat sipas propozimit përbëjnë kushtet për ngritjen e një komisioni hetimor, përkatësisht çështja duhet të bëjë me funksionin ligjvënës ose funksione të tjera të Kuvendit, objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete, duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme për ekzistencën e çështjes për të cilin kërkohet ngritja e komisionit hetimor.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave nuk gjejmë të reflektuar qëndrimin e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese se Kuvendi, në rast se kërkohet ngritja e një komisioni parlamentar nga një e katërta e deputetëve të Kuvendit, ka detyrimin që të mos ia nënshtrojë debatit parlamentar, por vetëm të diskutojë lidhur me shkallën e respektimit të parimeve kushtetuese në objektin e veprimtarisë së tij. Dhe në rast se shumica parlamentare ngre pretendime lidhur me mosrespektimin e parimeve kushtetuese, ajo ka të drejtë t’i propozojë pakicës formulime alternative, deri në arritjen e një konsensusi. Megjithatë, këto propozime alternative nuk mund të jenë të atilla sa të reduktojnë objektin e hetimit deri në atë masë sa t’ia pamundësojë komisionit kryerjen e veprimtarisë së tij (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007, nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

Mungesa e parashikimeve që shprehin qartë detyrimin e Kuvendit për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare kur kërkohet nga numri i përcaktuar në Kushtetutë i deputetëve, si dhe propozimi i formulimeve alternative lidhur me objektin e veprimtarisë nëse vlerësohet se çënohen parime a standarde kushtetuese, i jep mundësi mazhorancës që të vlerësojë në diskrecionin e saj përmbushjen ose jo të këtyre parimeve dhe pa bërë ndonjë përpjekje për të gjetur konsensus, të vendosë rrëzimin e kërkesave për ngritjen e komisioneve hetimore. Praktikisht, nga mënyra e formulimit të dispozitave të sipërcituara, ngritja ose jo e një komisioni hetimor është tërësisht në diskrecionin dhe interpretimin e mazhorancës. Kushtetutbërësi ka pasur për qëllim të shmangë pikërisht këtë lloj diskrecioni, i cili praktikisht e zhën këtë mekanizëm kontrolli që ka opozita në një shtet demokratik.

Për të vijuar me grupin e dytë të ndryshimeve, në nenin 7 përcaktohen rastet kur Komisioni, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë zhvillimin e mbledhjeve me dyert të mbyllura, përkatësisht në rastet kur i referohen fakteve që kanë të bëjnë me jetën personale të dëshmitarëve ose të palëve të treta, kur rrezikohet jeta, shëndeti dhe liria e dëshmitarit ose personit të lidhur me të, kur bëhen referenca për një sekret biznesi ose tregtar, informacion të klasifikuar si “sekret”, kur

publiciteti mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhen të mbahen sekret në interes të shtetit, kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit, në qoftë se një gjë e tillë, kërkohet nga organi kompetent, kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës dhe kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose kur gjykohet e nevojshme nga komisioni.

Lidhur me këtë dispozitë vlerësojmë se ajo vjen në kundërshtim me një prej qëllimeve kryesore që ka ngritja e një komisioni hetimor të Kuvendit. Konkretisht, komisionet hetimore ngrihen me qëllim njohjen dhe verifikimin e një fenomeni, një ngjarjeje ose një veprimtarie të caktuar. Pra, në thelb të veprimtarisë së komisioneve hetimore qëndron transparenca për median, opinionin publik dhe qytetarët. Shtimi i rasteve të zhvillimit të mbledhjeve me dyer të mbyllura, disa prej tyre mjaft evazive dhe që lënë vend për interpretim të gjërë, vetëm me votat e mazhorancës, vjen në kundërshtim me parimin e transparencës. Kjo pasi, rast pas rasti, anëtarët e mazhorancës do të vlerësojnë kur duhet të bëhet transparenca për aspekte të caktuara të veprimtarisë së komisionit dhe në cilat raste do të vepronet në mungesë transparence. Kjo dispozitë duhet të kufizohet vetëm në rastet kur të dhënat e trajtuara përbëjnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, siç ka qenë praktika e përhershme e punës së komisioneve ose përndryshe një vendimmarrje e tillë duhet t'i nënshtrohet një shumice të cilësuar.

Më tej, në nenin 8 parashikohet, që ndryshe nga përcaktimi aktual që marrja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve nga çdo anëtar i komisionit pranohet pa votim, marrja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve të kryhet me vendim të ndërmjetëm. Praktikisht, nëpërmjet kësaj dispozite synohet të sanksionohet që provat që do të merren dhe dëshmitarët që thirren të jenë tërësisht në vullnetin e mazhorancës, e cila ka edhe numrin më të madh të anëtarëve në komision. Pra, do të jetë mazhoranca që do të vlerësojë nëse një provë duhet të merret ose jo, apo nëse një dëshmitar duhet të thirret ose jo. Në fakt, një mekanizëm i tillë do ta zhbënte të drejtën e pakicës parlamentare për kryerjen e një hetimi efektiv, pasi të dhënat dhe dëshmitë që do të administroheshin nga komisioni do të ishin tërësisht në diskrecionin e mazhorancës.

Në nenin 10 parashikohet mënyra e trajtimit të dëshmitarëve të thirrur në komisionin hetimor. Pra, siç analizuar më lart fillimisht thirrja ose jo e një dëshmitari do t'i nënshtrohet vullnetit të mazhorancës. Nëse vendoset thirrja e një dëshmitari, ajo çka ai mund të dëshmojë, por edhe të pyetet sërish është e kufizuar. Kjo mund të vërehet për shembull në përcaktimin që dëshmitari nuk duhet të dëshmojë për çka flitet në publik dhe as të shprehë vlerësime personale. Më tej, për rastet e dëshmitarëve që janë thirrur nga prokuroria ose gjykata në një proces penal, për pyetjet e tyre do të merret leje paraprake nga prokuroria ose gjykata. Dëshmitari mund të refuzojë të përgjigjet në rast se ai vlerëson se ai vetë apo ndonjë person i lidhur me të ekspozohet ndaj hetimit sipas një procesi të rregullt ligjor.

Marrja e një autorizimi nga prokuroria ose gjykata është e paprecedentë në asnjë shtet të së drejtës apo shoqëri demokratike, edhe në kontekstin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Ashtu siç është shprehur Gjykata Kushtetuese në mënyrë të përsëritur ekzistenca e një procesi penal nuk përbën pengesë për veprimtarinë hetimore të Kuvendit, në kushtet kur qëllimet që ndjekin janë të ndryshme. Nga ana tjetër, dhënia e të drejtës dëshmitarit për të refuzuar përgjigjen në çdo rast që ai vlerëson se vetë apo persona të lidhur me të mund të ekspozohen ndaj hetimeve, mund të përdoret si taktikë nga dëshmitarët apo mbrojtësit e tyre për të refuzuar transparençën dhe llogaridhënien në raport me komisionin hetimor.

Duke i vlerësuar në tërësi të dy grupet e ndryshimeve, mund të arrijmë në konkluzionet se nëpërmjet këtij ligji mazhoranca socialiste ka synuar që të vendosë nën kontroll të plotë ngritjen ose jo të komisioneve hetimore të Kuvendit të kërkuara nga deputetët e opozitës parlamentare, si dhe në rast se pranohet ngritja e një komisioni, të shfrytëzojë mekanizmat ligjorë që e bëjnë të pamundur ushtrimin e një hetimi efektiv parlamentar.

Hyrja në fuqi e këtij ligji, që në mënyrë antikushtetuese nuk lejon kontrollin efektiv parlamentar nga ana e pakicës, do të minonte çdo mundësi dialogu mes palëve politike në Parlament, për gjetjen e një zgjidhje mbi situatën e krijuar. Në këtë kuptim, Presidenti i Republikës, si Kreu i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit, duhet të luaj rol in e tij kushtetuese për të nxitur dhe mundësuar dialogun politik mes palëve, ku përfshihet edhe diskutimi dhe miratimi konsensual i ndryshimeve në ligjin për Komisionet Hetimore.

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në mbështetje të nenit 85, pika 1, të Kushtetutës së Shqipërisë, kërkojmë kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 106/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8991, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit””.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

KRYETARI

Gazment BARDHI

